



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/145
Datë: 15.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Qasje në Dokumente Publike.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova –Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

KONCEPT DOKUMENT PËR FUSHËN E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

Prishtinë, 2017

Kapitulli 1: Hyrje

Në praktikën e shoqërive demokratike, çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes, dhe kjo përfshin edhe të drejtën për të kërkuar dhe për të marrë informata. E drejta e qasjes në dokumente është thelbësore në arritjen dhe mbrojtjen e të drejtave tjera, në sigurimin e demokracisë, si dhe në zhvillimin e vendit.

Qeveria dhe organizata tjera publike mbajnë informata të rëndësishme. Këto dokumente i mbajnë në emër të publikut, andaj edhe duhet që proaktivisht të publikojnë informata, si dhe të japin qasje njerëzve që duan ndonjë informatë specifike.

E drejta në qasje në dokumente publike është e bazuar në të dhënën themelore, se qeveria i shërben popullit. Këto informacione janë quajtur edhe “oksigjeni i demokracisë”, pasi janë esenciale për transparencë, llogaridhënie dhe qeverisje të mirë.

Para shpalljes së Pavarësisë, kjo e drejtë ishte e paraparë me Kornizën Kushtetuese, ndërsa ishte e rregulluar me Ligjin 2003/12 për qasje në dokumente zyrtare.

Tashmë kjo e drejtë është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹. Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton:

“1. Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike.”

“2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”

Ky koncept dokument ndërlidhet me Programin e Qeverisë², shtyllën e dytë, - Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor – konkretisht 2.6 - **Rritja e transparencës dhe e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje :**

“Duke synuar arritjen e standardeve më të larta në këtë drejtim, Qeveria do të bëjë përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e kornizës legislative dhe institucionale, por edhe në zbatimin e dispozitave ligjore, që sanksionohen nëpërmjet Kushtetutës, konventave ndërkombëtare dhe akteve të tjera juridike. Një qeverisje demokratike kërkon të forcohet marrëdhënia ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë së tyre, prandaj Qeveria e Kosovës do të ofrojë mekanizma për të ofruar informacionet për qytetarët që ata të sigurohen që interesat e tyre janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate”.

Poashtu parashihet edhe me Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2015³ - Prioriteti Strategjik i Qeverisë Nr.2. Sundimi i ligjit dhe shteti i së drejtës. Në pikën 2.9 Rritja e transparencës, pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje si dhe avancimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile- pjesa e tretë parashih hartimin e Koncept dokumentit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Ndërlidhet edhe me Strategjinë për Modernizimin e Administratës Publike⁴, në pjesën 7.3. Organizimi i Administratës Publike dhe Llogaridhënia. Në pikën 3 – Sigurimi i mekanizmave për qasje në dokumentet

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kapitulli 2 – Të drejtat dhe liritë themelore, neni 41
<http://ëëë.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

²http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_2015-2018__10_mars.pdf

³http://kryeministri-ks.net/repository/docs/PVPQ_2015_final_.pdf

⁴<https://map.rks-gov.net/institucion/Plan-and-Strategies/Strategjia-e-RAP.aspx>

dhe informata publike – ndër të tjera thuhet :

Megjithëkëtë përparim, edhe pse ekziston një strukturë institucionale (Zyra e Kryeministrit dhe Avokati i Popullit) që ka përgjegjësi për realizimin e kësaj të drejte, një nga problemet kryesore është mungesa e një institucioni qendror përgjegjës që do të shqiptoj sanksione për rastet e dështimit të publikimit të informatave dhe të moslejimit të qasjes në dokumentet publike pa dhënë arsyen ligjore.

I njëjti dokument, tek pjesa 8 - Objektivat Strategjike dhe Masat Kryesore—në pjesën për Organizimin e Administratës Publike dhe Llogaridhënien, ka vënë këtë objektiv të përgjithshëm strategjik : “Administratë publike transparente, të përgjegjshme, me sistem të qartë të llogaridhënies të karakterizuar me shërbim civil profesional, me struktura të brendshme administrative funksionale të bazuara në legjislacionin për administratën publike në pajtim me parimet e qeverisjes së mirë”.

Tek objektivat specifike, në pikën tre thuhet: “Avancimi i mekanizmave për qasjen në dokumentet dhe informatat publike”.

Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar për transparencë dhe për përkushtim ndaj parimeve të qeverisjes së hapur dhe llogaridhënese. Madje në kuadër të përpjekjeve të saj për të rrit transparencën, ka kërkuar anëtarësim në OGP- Organizatën e Partneritetit për Transparencë.

Më 9 korrik të vitit 2013 Qeveria e Kosovës në mbledhjen e saj⁵ ka marrë vendim për fillimin e procedurave për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatën Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP). Vendimi obligon Qeverinë e Kosovës që të zbatoj dhe të merr përsipër të gjitha obligimet e nevojshme në kuadër të anëtarësimit në OGP.

Në Planin Nacional të Veprimit 2014-2016 për Partneritetin për Qeverisje të Hapur⁶ thuhet:

“Si shtet i ri, Kosova vazhdon të ballafaqohet me një numër sfidash në të gjithë segmentet e shoqërisë, përderisa korrupsioni përbën një sfidë serioze për vendin. Rritja e transparencës është mënyra më e mirë për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin. Andaj, anëtarësimi i Kosovës në Partneritetin për Qeverisje të Hapur, mund të shihet si një mundësi për të intensifikuar përpjekjet e gjertanishme dhe, për të zhvilluar kapacitetet për rritje të transparencës”.

Në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2015 të Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit, presidentja e Republikës së Kosovës,⁷ ka folur për rëndësinë e mbrojtjes së sinjalizuesve.

“Qytetarët e Republikës së Kosovës janë aleati kryesor në luftën kundër korrupsionit. Sinjalizuesit e veprave penale të korrupsionit, të ashtuquajturit ëhistlebloëers duhet të inkurajohen duke u mbrojtur institucionalisht në mënyrë që të vazhdojnë raportimin te institucionet dhe mediat. Është obligim institucional i të gjithëve që raportimet e këtyre dukurive të shëmtuara dhe shumë dëmtuese për buxhetin e shtetit të trajtohen me urgjencë nga organet e hetimit dhe ndjekjes. Vonesa në trajtimin e kallëzimit të veprave nga sinjalizuesit është vonim i drejtësisë dhe njëherit dekurajim i angazhimit qytetar në këtë luftë.

Sot, nuk ka patriotizëm dhe nderim më të madh shtetit tonë dhe të së ardhmes së tij sesa raportim dhe vërtetim të veprave penale të korrupsionit.

⁵http://kryeministri-ks.net/repository/docs/vendimet_e_mbl_139.pdf

⁶http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_NACIONAL_I_VEPRIMIT_2014_-2016_PQH.pdf

⁷<http://ëëë.president-ksgov.net/?page=1.6.4045#.Vgjë6LdfyUk>

Nuk do të lejojmë që qytetarët të cilët denoncojnë rastet e korrupsionit të dëshpërohen nga sistemi i ndjekjes dhe i gjyqimit për shkak të zvarritjeve procedurale apo që guximi i tyre për të denoncuar vepra kriminale t'iu hakmerret atyre. Në Kosovën e vitit 2015 të ndodhë një praktikë e tillë është e turpshme”.

Në po të njëjtin takim, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,⁸, i ka quajtur heronj ata që denoncojnë korrupsionin.

“Sot ne duhet që luftën kundër korrupsionit ta kuptojmë si akt patriotik. Sot, shteti i Kosovës ka nevojë për këtë lloj patriotizmi. Ky patriotizëm duhet të kultivohet së pari brenda vet institucioneve, duke filluar nga elitat politike. Kjo nuk bëhet përmes edukimit apo fushatave të vetëdijesimit, por përmes veprimit të pakompromis të ligjit. Heronjtë që i duhen sot Kosovës janë heronjtë që denoncojnë dhe luftojnë korrupsionin”.

⁸<http://ëëë.kuvendikosoves.org/?cid=1.128.7269>

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe përkufizimi i çështjes

Shpjegim

Në nëntor të vitit 2010 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike⁹, i cili ka përmbajtur përmirësime të shumta nga Ligji i vjetër, megjithatë edhe në zbatimin e tij janë hasur vështirësi.

Raporti i Progresit nga Komisioni Evropian,¹⁰ i publikuar më tetë tetor 2014, thotë se “Progres shumë i limituar është bërë për të përmirësuar llogaridhënien dhe shërbimet publike. Ligjet për procedurën administrative dhe aktet nënligjore ende nuk janë kompletuar. **Zbatimi i Ligjit për qasje në dokumente publike mbetet i pakënaqshëm**”.

Poashtu, kritika janë dhënë edhe në Raportin e SIGMAS, “Vlerësimi i Reformës së Administratës Publike të Kosovës”¹¹.

Mbikëqyrja, sipas këtij raporti mbetet problemi kryesor, derisa theksohet se “*Mungesa e një trupe qendrore mbikëqyrëse me fuqinë e të dhënies të dënimeve në dështimin e dhënies së qasjes në dokumente publike.*”.

Problemet kryesore lidhen me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit.

Mbikëqyrës i zbatimit të Ligjit është Avokati i Popullit, të cilit nuk i jepet e drejta e plotë e mbikëqyrjes.

Neni 10 mbi Ligjin për qasje në dokumente publike thotë se përveç Institucionit të Avokatit të Popullit, kërkuesi i dokumentit mund të fillojë procedurën para gjykatës kompetente, por nuk specifikon se cila gjykatë dhe cili institucion.

Ligji aktual poashtu ka probleme edhe me konsistencën në mes të neneve 4 dhe 6. Neni 4 Paragrafi 4 thotë se “dokumentet publike të marra nga aplikuesi nuk mund të përdoren për denigrim, propagandistik dhe qëllime komerciale”, që do të ishte në kundërshtim me nenin 6, pika 2 ku “kërkuesi i një dokumenti nuk është i detyruar të deklarojë arsyet për të pasur qasje në dokumente”.

Për më shumë tek neni 12, që flet për përjashtimet e të drejtës për qasje në dokumente publike, listohen përjashtime të cilat janë të paqarta.

Ky nen liston mbrojtjen e mjedisit në listën e përjashtimeve të së drejtës në qasje në dokumente. Kjo është në kundërshtim me Direktivën e Këshillit Evropian 2003/4/CE për qasjen në dokumente publike të mjedisit. Qëllimi kryesor i kësaj direktive është e drejta e qasjes së lirë në informatat që kanë të bëjnë me mjedisin, pasi kjo inkurajon ndërgjegjësim më të madh për çështjet që ndikojnë në mjedis.

Pika dy e nenit 12 thekson se “Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1. Të këtij neni, përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin”.

Megjithatë, në Republikën e Kosovës nuk ka ndonjë test i cili saktëson se si mund të matet interesi publik.

⁹<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>

¹⁰http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20141008_kosovo_progress_report_2014_sq.pdf

¹¹<http://ëëë.sigmaëeb.org/publications/Kosovo-Assessment-2014.pdf>

Në vendet e Bashkimit Evropian, institucionet publike janë të obliguar që të bëjnë Test të Dëmit, si dhe Test të Interesit Publik, për të definuar nëse informatat që mund të bien nën ndonjërin nga përjashtimet e dhëna në Ligj, përmbajnë informata publikimi i të cilave është në interes të publikut.

Testi i Interesit Publik bëhet për të vlerësuar nëse publiku përfiton nga publikimi i këtyre informacioneve, dhe jo nëse ka interesim nga publiku apo nëse është interesant për kërkuesin e dokumentit.

Në Kosovë, dënime për mosrealizimin e qasjes në dokumente publike mund të japin vetëm gjykatat.

Për më shumë, ligji nuk kërkon nga institucionet publike të krijojnë mekanizma të brendshëm për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesave për qasje në dokumente publike. Madje një gjë e tillë theksohet edhe në Raportin nga SIGMA¹² – “Vlerësimi i Reformës së Administratës Publike të Kosovës”, ku thuhet se “Ligji nuk është shumë i qartë se kush vendos për refuzim”.

Nga ana tjetër, plotësimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike do t'i mundësonte Republikës së Kosovës që të ndiqte trendin e vendeve të Bashkimit Evropian të cilat tashmë informatat e institucioneve publike i bëjnë të qasshme edhe për përdorime komerciale.

E gjithë kjo është kërkesë e Direktivës së re të Komisionit Evropian për ripërdorimin e Informatave të Sektorit Publik¹³.

Ri-përdorimi nënkupton përdorimin e informatave të sektorit publik për një qëllim tjetër nga qëllimi fillestar për të cilin janë krijuar, mbajtur apo shpërndarë.

Informatat nga trupat e sektorit publik që krijohen në bazë të detyrës së tyre publike, janë të ri përdorshme në momentin që lejohet qasja, derisa nuk ka ndonjë kufizim apo përjashtim për ato informata.

Direktiva e parë për ripërdorimin e informatave të sektorit publik është miratuar në vitin 2003. Por, nga ajo kohë, informatat në botë, përfshirë edhe informatat publike janë rritur shumë. Paralelisht me këtë, jemi dëshmitar të një evolucioni të vazhdueshëm të teknologjisë për analizimin dhe përpunimin e këtyre të dhënave. Ky evolucion i shpejtë teknologjik mundëson krijimin e shërbimeve dhe aplikacioneve të reja, të cilat ndërtohen me përdorimin dhe kombinimin e informacioneve. Rregullat e parapara në Direktivën e vitit 2003 nuk po arrijnë të mbajnë tempin me ndryshimet e shpejta, dhe si rezultat i kësaj ka gjasa që të hupet mundësia sociale dhe ekonomie që mund të përfitohet nga këto të dhëna.

Ndryshimi kryesor që erdhi me ndryshimet, është fakti që të gjitha informatat e institucioneve publike tashmë bëhen informata të ri-përdorshme për qëllime tregtare dhe jo tregtare, nën kushte jo diskriminuese. Për më shumë, institucionet obligohen që të ndihmojnë kërkimet ‘online’ të informatave publike, duke bërë dokumentet në formate të lexuara nga makineritë.

Studimi i porositur nga Komisioni Evropian, i bërë në vitin 2008 nga Graham Vickery¹⁴, ka treguar se tregu i ripërdorimit të informatave të sektorit publik për 27 shtete anëtare të Bashkimit Evropian ishte 28 miliard euro në vitin 2008.

¹²<http://ëëë.sigmaëeb.org/publications/Kosovo-Assessment-2014.pdf>

¹³<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CONSLEG:2003L0098:20130717:EN:PDF>

¹⁴http://ec.europa.eu/information_society/neesroom/cf/document.cfm?doc_id=1093

Madje studimi ka treguar se ka një rritje të shpejt në këtë treg, me një rritje prej rreth 7% në vit.

Informatat e ndërlidhura me ripërdorimin e informative të sektorit publik, mund të përdoren në një gamë të gjerë të aplikimeve përgjatë gjithë ekonomisë. Ndikimi agregat direkt dhe indirekt në ekonominë e 27 shteteve anëtare vlerësohet të jetë rreth 140 miliard euro në vit.

Studimi poashtu ka sugjeruar se në vendet ku informatat janë të hapura për ripërdorim, ku ka qasje më të lirë dhe distribuim më të mirë, tregu i këtyre informative mund të rritet deri në 40 miliard euro, ndërsa përfitimet ekonomike agregate direkt dhe indirekte për ekonominë e 27 shteteve anëtare mund të jenë deri në 200 miliard euro (1.7 % e GDP-së).

Në terme të përfitimit nga efikasiteti i kësaj politike, përmirësimi i qasjes në informata e nevojshme për ndikimin mjedisor, mund të ul shpenzimet e shteteve të Bashkimit Evropian deri në 20%, apo rreth 2 miliard euro në vit, dhe poashtu nëse qytetarët evropian, secili prej tyre, arrin që të kursejnë së paku 2 orë në vjet nga shërbime më të shpejta të qasjes në informata, kjo mund të vlerësohet së paku 1.4 miliard euro në vjet.

Informata

Mungesa e fuqisë ekzekutive e Avokatit të Popullit bënë që të ketë probleme në zbatimin e Ligjit. Përveç këshillimit të institucioneve, Avokati i Popullit nuk mundet që të dënojë institucionet për mosdhënien e dokumenteve.

Neni 10 thotë se:

“mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuarit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve tjera publike, gjykatës kompetente...megjithatë nuk definohet se cilët janë institucionet tjera publike.

Institucionet tjera publike përmenden edhe në nenin 17, që flet për vetë institucionin e Avokatit të Popullit, nën pika 4 “Pala e pakënaqur në procedurën e realizimit të së drejtës në qasje në dokumente publike, mund ti drejtohet me ankesë edhe institucioneve të tjera publike”.

Praktika e tillë e rregullimit institucional nuk ka qenë efektive gjatë zbatimit. Sipas organizatë joqeveritare ndërkombëtare “Right2info”¹⁵, Avokati i Popullit nuk ka shumë fuqi në shoqëritë që kalojnë në tranzicion, meqenëse ka shumë punë që bëjnë dhe nuk kanë kohë që ekskluzivisht të merret vetëm me qasjen në dokumente publike.

Si një çështje administrative, është me rëndësi që institucioni mbikëqyrës të ketë resurse të mjaftueshme për të bërë detyrat e tij.

Me ligjin e tanishëm, nuk është mjaft e qartë nëse kërkuari i dokumentit, pas ankesës tek institucioni gjegjës, duhet gjithsesi të bëjë ankesë të Avokatit të Popullit, apo mundet që direkt të shkoj në Gjykatë.

¹⁵<http://ëëë.right2info.org/information-commission-ers-and-other-oversight-bodies-and-mechanisms#section-3>

Në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian mbikëqyrjen e zbatimit e bënë Komisioneri për Informim.

Ndër veçoritë tjera të Komisionerit janë:

- Kualiteti i kornizës Ligjore për qasje në dokumente publike
- Kualiteti i ligjeve që rregullojnë procedurën administrative, dhe ligjeve tjera që ndërlidhen me përjashtimet (ligjet e klasifikimit të informatave, mbrojtjen e të dhënave personale, sekretet tregtare)
- Aktivitetet për ngritjen e vetëdijes
- Kontrollimi i informacioneve Proaktive
- Raportimi i rregullt në Kuvend- e drejta për inicim të debatit parlamentar
- Përmbledhje e institucioneve që përfshihen nga Ligji
- Testi i interesit dhe testi i dëmit
- Sanksionet
- Vendimet e tij mund të kundërvihen vetëm pranë Gjykatës së përcaktuar me Ligj – shkalla e tretë- Gjykata Administrative

Ekzistimi i një trupe mbikëqyrëse për Ligjin për Qasje në dokumente publike me fuqi ekzekutive ul edhe shpenzimet nëpër gjykata.

Është praktikë poashtu që ligjet e lirisë së informimit, të mundësojnë edhe mbrojtjen e “sinjalizuesve”. Organizata joqeveritare me seli në Londër “Article19”¹⁶, në modelin e tyre të Ligjit për Lirinë e Informimit, theksojnë se është e domosdoshme mbrojtja e personave të cilët publikojnë informacione në kundërshtim me obligimin e tyre ligjor që këto informata të jenë konfidenciale, për të mbrojtur interesin e publikut dhe për të treguar “keçbërjen”.

“Keçbërja” në këtë kontekst përfshin gjëra si korrupsioni, shfrytëzimi i detyrës zyrtare, kryerja e veprave kriminale apo ndonjë veprim tjetër anti ligjor.

Mbrojtja ligjore e tyre do të thotë që kur zbulimi i këtyre informacioneve të bëhet, këta punonjës mos të pësojnë sanksione administrative që lidhen me punën e tyre.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike dështon që të siguroj një mbrojtje të tillë.

Përjashtimet e listuara në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike duhet të kenë përjashtime të shpjeguara më mirë. Neni 12 për “përjashtimet e së drejtës së qasjes në dokumente” duhet të rishikohet. Si shembull, Neni 12, paragrafi 1.10 liston mbrojtjen e mjedisit në listën e përjashtimeve të së drejtës në qasje në dokumente.

Direktiva e Këshillit Evropian 2003/4/CE për qasje publike në informata të mjedisit¹⁷ thotë të kundërtën. Parimi kryesor i kësaj direktive është se publikimi i informatave të mjedisit do të inkurajoj vetëdijesim më të madh sa i përket mbrojtjes së mjedisit. Vetëdijesimi më i madh ndihmon në rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Poashtu i bënë institucionet publike më transparente dhe llogaridhënese dhe ndërton një mirëbesim tek publiku për institucionet.

Burimi i kësaj Direktive është një marrëveshje ndërkombëtare e quajtur “Konventa për Qasje në Informata, Pjesëmarrje e Publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi lidhur me çështjet mjedisore”. Është miratuar në Aarhus, Danimarkë më 25 qershor 1998 dhe është e njohur si “Konventa e Aarhus”¹⁸.

¹⁶<https://eëë.article19.org/data/files/pdfs/standards/modelfoilaë.pdf>

¹⁷<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2003:041:0026:0032:EN:PDF>

¹⁸<http://eëë.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>

Nënshkruesit e kësaj Konvente janë pajtuar që të publikojnë dokumentet që përmbajnë informata mjedisore.

Andaj, mjedisi nuk gjendet si përjashtim në ligjet e lirisë së informacionet as në Slloveni, Kroaci, Mal të Zi apo në Maqedoni.

Në fakt, legjislacioni slloven e liston mjedisin si një përjashtim nga përjashtimet, që nënkupton se edhe në qoftë se një dokument është i listuar si përjashtim, në qoftë se ai dokument përmban informacion lidhur me mjedisin me automatizëm kalon në kategorinë e dokumenteve të qasshme.

Ligji i Kosovës duhet të jetë më specifik edhe tek përjashtimi tjetër i listuar tek i njëjti nen, pika 1.6. "privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat", pasi si formulim i tillë "interesave të tjerë legjitim privat" është shumë gjithëpërfshirës, andaj duhet të riformulohet vetëm si "privatësisë".

E njëjta vlen edhe për pikën 1.7 "interesave komerciale dhe të tjera ekonomike" e që duhet limituar sipas praktikave të përgjithshme vetëm në "sekrete tregtare".

Për më tepër, të gjitha dokumentet që përmbajnë të dhëna për shpenzimet nga buxheti i shtetit duhet të jenë të qasshme.

Paqartësi ka edhe tek Neni 4 Paragrafi 4 që thotë se "dokumentet publike të marra nga aplikuesi nuk mund të përdoren për denigrimim, propagandistik dhe qëllime komerciale", e që është në kundërshtim me nenin 6, pika 2 ku "kërkuesi i një dokumenti nuk është i detyruar të deklarojë arsyet për të pasur qasje në dokumente".

Neni 12, pika 2 e këtij ligji përkufizon "Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1. Të këtij neni, përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin".

Institucionet e Kosovës nuk kanë bërë akoma një test të interesit. Në shtete e rajonit, institucionet janë të obliguara që të bëjnë në dy teste, **testin e interesit publik dhe testin e dëmit**.

Sipas fjalorit të Random House, interesi publik përkufizohet si "Mirëqenia e publikut të përgjithshëm, e mira e përgjithshme".

Testi i interesit publik bëhet në tre hapa:

1. Identifikimi i interesit publik në favor të qasjes në informata.
2. Identifikimi i interesit publik relevant kundër qasjes në informata
3. Vendosja e baraspeshës duke konsideruar interesat publike kundër dhe pro qasjes në informatë, dhe gjetja e ekuilibrit në mes të këtyre dy interesave të kundërta.

Institucionet duhet të balancojnë nevojën për mbrojtjen e disa informacioneve nga publiku, dhe interesin publik që do të përfitojë nga publikimi i këtyre informacioneve. Interesi publik nuk ka gjithmonë përparësi në raste të tilla, që do të thotë, jo gjithçka që i intereson publikut duhet të publikohet. Me fjalë të tjera, institucionet duhet të konsiderojnë nëse informata që kërkohet shkel ndonjë interes tjetër të mbrojtur, dhe nëse përfitimi i publikut është vërtetë më i madh në këtë rast specifik.

Probleme ka edhe me Rregulloren nr. 02/2012/mf për tarifën në qasje në dokumente publike¹⁹. Kjo rregullore ngarkon të gjithë kërkuesit e dokumenteve në kopje fizike me pagesa të veçanta, çmime të cilat bëhen të paarsyeshme kur në të futen edhe shpenzimet e mëdha bankare që i ngarkohen kërkuesit të dokumenteve (vetëm për shërbim bankar duhet të paguajnë 1.5 euro).

Në legjislacionin sloven, është e përcaktuar që institucionet publike nuk duhet të ngarkojnë me pagesë kërkuesin për kopje të dokumentit në qoftë se vlera e pagesës është më e vogël se 10 euro.

Probleme të theksuara ka edhe tek proaktiviteti në faqet zyrtare. Udhëzimi administrativ nr. 03/2011 për ueb faqet e institucioneve publike²⁰ në nenin 15 mbikëqyrja thotë: “Mbikëqyrja e zbatimit të këtij udhëzimi administrativ e bën organi përgjegjës për e-qeverisje”. Në praktikën e shteteve tjera, përpos anës teknike, organi përgjegjës për e-qeverisje nuk mbikëqyr edhe përmbajtjen e ueb faqeve. Një gjë e tillë i mbetet institucionit të pavarur mbikëqyrës për realizimin e të drejtës së qasjes në dokumente publike.

Madje, ka pasur një zhvillim tjetër viteve të fundit, e cila kërkon që informatat e sektorit publik të jenë të qasshme dhe të përdorshme edhe për gjëra komerciale, dhe jo për informim – sipas Direktivës për Ripërdorimin e Informatave të Sektorit Publik.

Në Kosovë nuk është e rregulluar ripërdorimi i informatave të sektorit publik.

Portali i të dhënave të hapura data.rks-gov.net është në hapat e parë të funksionalizimit. Megjithatë, nuk ka legjislacionin adekuat që e rregullon këtë fushë.

Në Kroaci dhe Slloveni është i njëjti ligj që e rregullon edhe këtë fushë. Ajo që vlen të theksohet është se në këto dy shtete, është pikërisht shkalla e dytë, Komisioneri i Informimit që e mbikëqyr edhe këtë të drejtë.

Këto të drejta janë të garantuara me Direktivën 2013/98/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që e amandamenton Direktivën 2003/98/EC për ri përdorimin e informatave të sektorit publik²¹.

Me këtë direktivë të re, nga institucionet publike kërkohet :

- Të bëjnë informatat e tyre të ri-përdorshme për qëllime tregtare dhe jo tregtare, nën kushte jo diskriminuese
- Procedojnë kërkesat dhe të lejojnë qasje brenda 20 ditëve (ose 40 më së shumti nëse kërkesa është e gjerë); të justifikojnë vendimet negative dhe të informojnë për mënyrën se si mund të ankohet kërkuesi më tej.
- Mos të ngarkojnë kërkuesit me shpenzime më të mëdha se ato të kopjimit
- Publikojnë licenca në formate digjitale
- Ndihmojnë kërkimin online, duke bërë dokumente të lexuara nga makineritë.

Politika aktuale

Zyra për Komunikim me Publiku në Zyrën e Kryeministrit është përgjegjëse për përgatitjen e Raportit Gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, për vitin paraprak, dhe deri në fund të muajit mars të vitit përkatës, të dërgoj një kopje për njoftim në Kuvendin e Kosovës.

¹⁹<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10015>

²⁰<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>

²¹Shih fusnotën 14

Poashtu, Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike bën rekomandime, duke përfshirë nëse është nevojta propozimet për rishikimin e këtij ligji, si dhe përgatit Programin e Veprimit për masat që duhen ndërmarrë nga institucionet, dhe sipas nevojës, ndërmerr masat e nevojshme për të promovuar dhe përkrahur të drejtat themelore për qasje në dokumente tek punonjësit e institucioneve publike.

Por, Organi i pavarur për qasje në dokumente publike është Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili ndihmon qytetarët për realizimin e së drejtës për qasje në dokumentet e nevojshme të cilat u janë refuzuar. Detyrë e këtij institucioni mbetet ndërmarrja e masave të nevojshme për të promovuar dhe përkrahur të drejtat themelore për qasje në dokumente, dhe t'ia paraqesë Kuvendit raportet e rregullta për zbatimin e së drejtës për qasje në dokumente zyrtare, nga institucionet publike. Megjithatë, Avokati i Popullit nuk ka fuqi ekzekutive kur Ligji nuk zbatohet.

Forcimi i vëmendjes tek qasja në dokumente publike dhe mundësia e hapjes së të dhënave zyrtare mund të bëhet vetëm nëse forcohet mbikëqyrja nga Kuvendi i Kosovës.

Është me rëndësi poashtu të definohet qartë roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e Ligjit. Kuvendi i Kosovës përmendet në ligj vetëm në nenin 20, pika 5.2 që thotë se njësisia përkatëse e Zyrës së Kryeministrit “dorëzon një kopje të raportit gjithëpërfshirës në Kuvendin e Kosovës”.

Ndonëse tashmë janë dorëzuar 4 Raporte Vjetore, asnjëherë Kuvendi i Kosovës nuk ka diskutuar për to. Asnjëherë Zyra për Komunikim Publik nuk është ftuar që të prezantoj të dhënat.

Raporti gjithëpërfshirës i përgatitur nga Zyra për Komunikim Publik i Zyrës së Kryeministrit i dërgohet Kuvendit vetëm për njoftim.

Avokati i Popullit nuk bënë raport të veçantë për Qasjen në Dokumente Publike në Kuvend, ashtu siç parashihet në nenin 17, pika 2.2 “t'ia paraqesë Kuvendit raportet e rregullta për zbatimin e së drejtës për qasje në dokumente zyrtare, nga institucionet publike”. Në Raportet Vjetore, Avokati i Popullit ka një pjesë të veçantë që i dedikohet Qasjes në Dokumente Publike.

Kuvendi i Kosovës nuk është i përfshirë drejtpërdrejt në mbikëqyrjen e këtij Ligji, pasi edhe përgjegjësia e mbikëqyrjes është e shpërndarë në disa institucione.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejt nga Kuvendi lidhur me këtë çështje, do të bënte që vetë institucionet shtetërore të jenë më të përgjegjshme para publikut.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Neni 41i Kushtetutës së Republikës së Kosovës flet për të Drejtën e Qasjes në Dokumente Publike. Ky nen përcakton se:

1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.
2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

Bazuar në obligimet që dalin nga ky nen i Kushtetutës, në tetor të vitit 2010, ka hyrë në fuqi Ligji Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

Aktet nënligjore²² të nxjerra nga ky ligj janë:

- Rregullorja nr. 03/2011 për shërbimin e komunikimit qeveritar me publikun;
- Rregullorja nr. 1/2012 për Kodin e Etikës për zyrtarët e komunikimit me Publikun;
- Rregullorja nr. 04/2012 për evidencën zyrtare të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe pakoja e dokumenteve standarde për kërkesat për QDP;
- Rregullore nr. 02/2012/MF për tarifatat në qasje në dokumente publike
- Udhëzimi Administrativ nr. 03/2011 për UEB-faqet e Institucioneve Publike;
- Udhëzimi Administrativ nr 02/2011, për portalin qeveritar të Republikës së Kosovës.
- Udhëzim Administrativ nr. 2008/09 për transparencën në komuna

Problemi kryesor Ligjit i mbetet Mbikëqyrja, e cila është e pamjaftueshme dhe e shpërndarë në shumë institucione. Institucionet publike duhet të përgatisin Raporte periodike dhe vjetor për Zyrën për Komunikim me Publikun të Zyrës së Kryeministrit, ndërsa në rast të refuzimeve, duhet t'i përgjigjen Avokatit të Popullit.

Rregullorja për tarifatat në qasje në dokumente publike ende nuk është në funksion.

Neni 10 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike thotë se “Refuzimi i kërkesës së kërkuarit, si dhe mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuarit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi”.

Por, heshtja administrative është mënyra më e shpeshtë se si Refuzohen kërkesat për qasje në dokumente publike nga të gjitha institucionet, duke mos lëshuar aktvendim me shkrim për të dhënë një arsyetim se pse i është refuzuar qasja në dokumente publike kërkuarit.

Me përjashtime të vogla, shumica e institucioneve publike nuk kanë krijuar mekanizmat e brendshëm për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

Vetëm në vitin 2014, në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës ka pasur 2073 kërkesa²³. Nga gjithsej 86 refuzime, 50 prej tyre janë bërë me heshtje administrative, pa përgjigje, dhe vetëm në 36 raste është dhënë arsyetim me shkrim.

²²<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>

²³<http://kryeministri-ks.net/repository/docs/SHQIP-FINAL.pdf>

Pasqyra e përgjithshme e kërkesave për qasje në dokumente publike për vitin 2014 në institucionet e Republikës së Kosovës

Institucioni / njësia vartëse	Qasja e lejuar	Qasja e refuzuar	Qasja e kufizuar	Pa përgjigje	Tjera	Totali
Institucionet qendrore: Kuvendi, Presidenca, Gjykata Kushtetuese	27	2	4	0	0	33
Qeveria, përfshirë ministrinë dhe agjencitë vartëse	736	9	25	25	56	851
Institucionet e Pavarura	201	5	0	0	1	207
Universitetet	41	1	0	1	0	43
Ndërmarrjet Publike	15	1	0	0	0	16
Komunat	846	18	9	24	26	923
Totali	1866	36	38	50	83	2073

Shpeshherë vendimmarrja është lënë në fatin e zyrtarit për pranimin dhe trajtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, edhe në rastet e rishqyrtimit të çështjeve.

Sipas Ligjit, kur kërkuesi është i pakënaqur me përgjigjen, ka kohë 15 ditë që të dërgojë kërkesë për rishqyrtimin e çështjes, dhe vendimin për këtë e merr “eprori i institucionit kompetent publik i Republikës së Kosovës”, që lejon qasje në dokumentin e kërkuar ose me një përgjigje me shkrim jep arsytet për refuzimin e plotë apo të pjesshëm.

Programi aktual

Të gjitha institucionet publike janë të obliguara që të bëjnë publike dokumentet e tyre të qasshme. Për këtë gjë, ata duhet të emërojnë personin përgjegjës për pranimin dhe trajtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, i cili poashtu është i obliguar që të mbajë evidencë të saktë të numrit të kërkesave për qasje në dokumente publike, dhe nga këto të krijojë Raporte periodike dhe vjetore.

Kërkuesi i dokumentit, në rast se është i pakënaqur me përgjigjen e institucionit, brenda 15 ditëve ka kohë që të bëjë kërkesë për rishqyrtimin e çështjes, dhe vendimin për këtë, institucioni duhet ta marrë brenda 7 ditëve.

Në rast se sërish mbetet i pakënaqur me përgjigjen, mund t’i drejtohet- por nuk është i obliguar- Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili pasi heton rastin, i drejtohet me Rekomandime institucionit.

Dhe krejt në fund, kërkuesi i pakënaqur me përgjigjen mund të drejtoj aktakuzë në ‘gjykatën kompetente’, por në ligj nuk është e përcaktuar se cila është ajo gjykatë.

Kërkuetit e dokumenteve të cilët nuk arrijnë që të realizojnë të drejtën për qasje në institucionin ku kanë bërë kërkesë, zvarriten me procedura tek institucionet tjera, megjithatë nuk kanë ndihmë konkrete për të realizuar këtë të drejtë të tyre.

Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit, në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike është e obliguar që të përgatitë Raport Gjithëpërfshirës vjetor për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike të institucioneve të Republikës së Kosovës

Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, institucionet e Republikës së Kosovës duhet të ofrojnë qasje në dokumente publike. Po ashtu, institucionet publike janë të obliguara që të mbajnë evidenca zyrtare për kërkesat për qasje, të cilat duhet të përmbledhen në raport.

Janë rreth 160 institucione publike të cilat janë të mbuluara me Ligj, por jo të gjitha janë pjesë e politikës aktuale.

Shumë prej tyre refuzojnë që të dërgojnë raportet e tyre tek Zyra për Komunikim me Publikun e ZKM-së²⁴. Institucioni i Avokatit të Popullit, më 15 shkurt 2012 na është drejtuar me një njoftim, duke pohuar se nuk do të dërgoj raport tek ne, pasi ky raport do të përfshihet në Raportet e tyre vjetore dhe do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, institucionit të cilit i raportojnë dhe nga i cili janë themeluar.

Po në fillim të vitit 2012, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial në një mbledhje të përbashkët kanë vendosur mos të dërgojnë raporte tek Zyra për Komunikim me Publikun në ZKM, duke e konsideruar raportimin e tillë si shkelje të pavarësisë së tyre institucionale.

Me rregulloren nr 04/-2012 për Evidencën Zyrtare ë Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike²⁵, Këshilli Gjyqësor mbledh raportin për gjykatat dhe e dërgon në ZKP-ZKM, ndërsa Këshilli Prokurorial mbledh raportin nga të gjitha prokuroritë.

Institucionet që nuk kanë raportuar në vitin 2013:

- Avokati i Popullit
- Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
- Agjencioni Kosovar i Inteligjencës
- Prokurori i Shtetit
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- Këshilli Prokurorial i Kosovës
- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas

Për arsye politike pjesë e raportit nuk janë edhe:

- Komuna e Zveqanit
- Komuna e Leposaviqit
- Komuna e Zubin Potokut
- Komuna e Mitrovicës Veriore

²⁴<http://kryeministri-ks.net/repository/docs/S HQIP-FINAL.pdf>, faqe 48

²⁵<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8355>, neni 5

Shpenzimet aktuale

<i>Kategoria e shpenzimeve</i>	<i>Shpenzimet faktike në vitin paraprak</i>	<i>Buxheti këtë vit</i>	<i>KASH për vitin e ardhshëm</i>
<i>Buxheti i Ministrisë</i>			
<i>Buxhetet tjera</i>			
<i>Financimi nga donatorët</i>			
<i>Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave</i>			

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Kushtetuta e Kosovës i jep secilit të drejtën e qasjes në dokumente publike. Edhe Korniza legislative definon qasjen në dokumente publike dhe është një rregullativë në vijë me standardet e mira evropiane dhe siguron një balancim të drejtë në mes të interesit për të pasur transparencë dhe mbajtjes së informatave konfidenciale.

Poashtu, kërkesat për qasje trajtohen me formalitete minimale dhe afati i përgjigjes është në të mirë të kërkuarit, pasi është vetëm shtatë ditë kalendarike.

Mungesa e një trupe qendrore mbikëqyrëse me fuqinë e të dhënies të dënimeve në dështimin e dhënies së qasjes në dokumente publike është sfida kryesore.

Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon institucionet, megjithatë nuk ka sukses në zbatimin e këtyre rekomandimeve tek të gjitha institucionet.

Poashtu, institucionet publike nuk kanë ndonjë trup qendrore e cila do të mund t'i udhëzonte ata në raste të veçanta se si duhet të veprojnë. Mungesa e kësaj trupe mbikëqyrëse sjell probleme edhe në Raportin Gjithëpërfshirës, pasi që aktualisht Zyra për Komunikim me Publikun në ZKM nuk ka të drejtë që të auditojë këto të dhëna, dhe si rrjedhojë, shpeshherë ka shumë gabime në to.

Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që ndryshimi i Ligjit të përfshijë edhe Direktivën e EU-së për ripërdorim të informatave të sektorit publik. Kjo do të bëjë që të rritet edhe në Kosovë tregu nga informatat e institucioneve publike, dhe të arrihet trendi i Bashkimit Evropian në këtë drejtim.

Përvoja nga shtetet tjera

Në Republikën e Sllovenisë organi mbikëqyrës është Komisioneri i Informimit²⁶, që është institucion i pavarur i cili mbikëqyr zbatimin e ligjit për qasje në dokumente publike dhe atë të të dhënave personale. Është institucion i shkallës së dytë, i cili ka të drejtë të inspektojë dhe të gjobisë për kundërvajtje.

Vendimet e Komisionerit nuk mund të refuzohen nga institucionet e mbikëqyrura. Për këto vendime institucionet dhe qytetarët mund të ankohen vetëm në Gjykatën Administrative nëse nuk pajtohen

Në Slloveni, Komisioneri për informim:

²⁶<https://ëëë.ip-rs.si/?id=195>

- vendos kundër vendimit të lëshuar nga ndonjë trupë publike që ka refuzuar kërkesën për qasje, ose ka shkelur të drejtën për ri përdorim të informatave,
- mbikëqyr zbatimin e Ligjit që garanton qasje në informata publike dhe të rregulloreve të miratuara brenda kornizës për procedurat e ankesës.

Në rast të refuzimit të një kërkesë për qasje në dokumente parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të kërkojë nga zyrtari për marrëdhënie me publikun, i institucionit përkatës në dispozicion të dokumentit, që të bëjë testin. Autoritetet përgjegjëse; për qeverinë është Zyra e Kryeministrit, ndërsa për gjykatat është Gjykata Supreme.

Në Kroaci, Komisioneri për Informim²⁷ zgjidhet në mes të dy kandidatëve me votat e deputetëve të Kuvendit të Kroacisë. Mbikëqyr vetëm Ligjin për Lirinë e Informimit (ekuivalenti i Ligjit për qasje në dokumente publike).

Institucionin që e drejton, Institucioni i Komisionerit për Informim, ka pavarësi të plotë financiare, duke marrë fonde të mjaftueshme për të siguruar aktivitetet cilësore dhe stafin profesional. Bën udhëzimin dhe trajnimin e të gjithë zyrtarëve të institucioneve publike. Ka fuqi që të auditojë dhe të dënojë institucionet. Poashtu, ka autonomi të plotë në marrjen e vendimeve, pasi që vetëm Gjykata mund të shikoj vendimet e saj.

Neni 16 i Ligjit në Kroaci²⁸ tregon arsyet kur bëhen testi i dëmit dhe testi i interesit publik. Në udhëzuesin e këtij shteti për lirinë në informata, theksohet se interesi publik duhet të kuptohet si i lidhur me vlera sociale dhe demokratike, sikurse janë gjyqësori i pavarur, integriteti, transparencja, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë. Derisa vëmendja e medieve në një çështje të caktuar mund të merret në konsideratë si indikacion se ka interes publik, kjo gjë nuk duhet të jetë kriteri i vetëm për publikimin e informatave, pasi duhet të konsiderohet edhe mbrojtja e interesave dhe vlerave tjera të njohura ligjore.

Poashtu, thuhet se kur të bëhet testi i dëmit, institucionet publike duhet të vlerësojnë se sa shumë informata duhet të publikojnë, e që mjaftojnë për të mbrojtur interesin publik, dhe sa shumë informata duhet që të mbajnë të mbyllura.

Në Shqipëri ekziston Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale²⁹. Që nga shtatori i këtij viti, E drejta për informim do të trajtohet administrativisht duke përfshirë rolin vendimmarrës të Komisionerit për të drejtën për informim dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve

Në nenin 20 të Ligjit për të Drejtën e Informimit, precizohet se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale raporton në Kuvend ose në komisionet parlamentare të paktën një herë në vit ose sa herë që kërkohet prej tyre. Gjithashtu, ai mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që i çmon të rëndësishme. Raporti përmban të dhëna dhe shpjegime për zbatimin e së drejtës për informim në Republikën e Shqipërisë, si dhe programet e transparencës.

²⁷<http://ëëë.pristupinfo.hr/en/>

²⁸http://digured.srce.hr/arhiva/263/100541/narodne-novine.nm.hr/clanci/sluzbeni/2013_02_25_403.html

²⁹<http://ëëë.idp.al/index.php/sq/>

Në Maqedoni, ekziston Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë më informacione me karakter publik³⁰, i cili ka fuqi që ta obligojë poseduesin e informatës, pra institucionin publik, ta japë informacionin e kërkuar. Por, poashtu, ka të drejtë edhe të ndalë procedurën me përmbyllje.

Ky komision ka në mandat:

- Kujdeset për zbatimin e dispozitave nga ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik;
- Përgatit dhe shpall listë të poseduesve të informacioneve;
- Jep mendime dhe propozime të ligjeve me të cilat rregullohet qasje e lirë në informacione;
- Ndërmerr aktivitete të planit për edukimin e poseduesve të informacioneve për mundësimin e kërkuesve për mundësimin e qasjes së lirë për kërkuesit e informacioneve me të cilat ata disponojnë;
- Bashkëpunon me poseduesit e informacioneve në kuadër të realizimit të së drejtës për qasje në informacione;
- Jep propozime për mjetet e nevojshme për punë të Komisionit gjatë përgatitjes së Buxhetit të Republikës së Maqedonisë; – Sjell Rregullore për punën e vet;
- Përgatit raport vjetor për punën e vet dhe e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë;
- Kryen punë të bashkëpunimit ndërkombëtar lidhur me ekzekutimin e obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë, pjesëmarrje në zbatimin e projekteve të organizatave ndërkombëtare dhe bashkëpunon me organet dhe institucionet e vendeve tjera nga lëmia e qasjes së lirë në informacione me karakter publik;
- Sjell Statut, si dhe akte të tjera me të cilat e rregullon mënyrën e punës dhe organizacionin e Komisionit dhe;
- Kryen edhe punë të tjera të vërtetuara me Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik dhe me ligj tjetër.

Në Mali të Zi funksionon Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale dhe lirinë e informatave³¹, e cila ka afat 15 ditë pas marrje së ankesës, që të përgjigjet.

Poashtu, ata janë përgjegjës për dhënien e dënimeve në rastet kur vërtetohet se kjo e drejtë është shkelur nga institucionet publike.

Kjo Agjenci:

1. mbikëqyr ligjshmërinë në vendimet administrative të nxjerra nga institucionet , pas një kërkesë për qasje në informacion, dhe ndërmerr të gjitha masat për të zbatuar ligjin.
2. Menaxhon sistemin e informimit për qasje në informacion
3. Monitorin gjendjen në fushën e qasjes në informacion dhe harton raporte për këtë gjë,
4. Bënë inspektime në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, sidomos duke hartuar dhe përditësuar udhëzues për qasje në informacion, duke mbikëqyr informatat e publikuara proactive, si dhe shpërndarjen e dokumenteve dhe të dhënave me qëllim të menaxhimit të sistemit të qasjes në informacion.
5. Dorëzon kërkesa për hapje të procedurës për kundërvajtje, për gjërat që janë jashtë kompetencës së saj për inspektim
- 6) bëjnë edhe detyra tjera të përshkruara me Ligj.

Autoritetet publike kanë kohë pesë ditë nga data e marrjes së kërkesës për sqarim, që të bëjnë një gjë të tillë tek Këshilli i Agjencisë.

³⁰<http://ëëë.komspi.mk/al/>

³¹<http://ëëë.azlp.me/index.php/me/>

Në Mal të Zi, testi i dëmit dhe testi i interesit publik precizohen në nenin 16 dhe 17 të Ligjit për qasje të lirë në informata³². Testi i dëmit duhet të konsideroj të gjitha informatat të cilat janë të mbrojtura me ligj, por theksohet se një test i tillë nuk bëhet për dy përjashtimet e para të nenit 14 të Ligjit “Refuzimet në qasje në informacione”:

Institucioni mund të ndaloj qasjen në informacion, nëse bëhet fjalë për :

1. Mbrojtjen e privatësisë sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, por jo edhe në rastin kur bëhet fjalë për
 - Funksonar publik në lidhje me ushtrimin e detyrave të tyre, si he të ardhurat e tyre, pronat dhe konflikti i interesit të këtyre personave, që janë të rregulluara me ligjin për konfliktin e interesit;
 - Mjetet e ndara nga buxheti publik, me përjashtim tëp ërfitimeve sociale, kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjen kundër papunësisë
2. Siguria, mbrojtja , interesat monetare dhe ekonomike si dhe të politikës së jashtme të Malit të Zi, në përputhje me ligjin për klasifikimin e informacioneve de verifikimin e sigurisë.

Sa i përket testit të interesit publik, ligji malazez thotë se interes publik konsiderohet kur zbulimi i informatave tregon në:

- 1- korrupsion, shkelje e ligji, harxhim kundër ligjor i burimeve publike ose abuzim i autorizimit në ushtrimin e funksioneve publike;
- 2- dyshimin se ka kryer vepra penale ose dyshimit të bazuar se ka kundërshtuar vendimet e gjykatës
- 3- marrja apo shpenzimi i të hyrave buxhetore kundërligjshëm
- 4- kërcënimi i sigurisë publike
- 5- kërcënimi i jetës
- 6- kërcënimi i shëndetit publik
- 7- kërcënimi i mjedisit.

³²<http://ëëë.sluzbenilist.me/PravniAktDetalji.aspx?tag=%7B4E05F2A9-6EF6-43F9-B168-396AF8619892%7D>

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Rritja e transparencës së institucioneve publike. Bërja e informacioneve publike për qytetarët, në bazë të kërkesave, për të siguruar një sistem të hapur qeveritar.

Botimi proaktiv dhe qasja në sa më shumë informatave që është e mundur, do të bëjë qytetarin pjesë të vendimmarrjes.

Bërja e informacioneve në formate të lehta për ripërdorim, formate të hapura të lexuara nga makineritë.

Stimulimi i rritjes ekonomike përmes ripërdorimit të informatave të sektorit publik.

Promovimi i angazhimit shoqëror në vendimmarrje.

Objektivat


- Përcaktimi i shkallës së dytë dhe të tretë në realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike. Shkalla e dytë të jetë një trup mbikëqyrëse me fuqi ekzekutive, e cila edhe jep dënime për institucionet.
- Obligimi për të publikuar në mënyrë proaktive dhe mbikëqyrja e informatave që gjenden në uebsajtet zyrtare
- Promovimi i qeverisjes së hapur, mbajtja e mbledhjeve të hapura dhe publikimi i dokumenteve që janë duke u hartuar
- Bërja e dokumenteve publike të qasshme edhe për përdorim nga bizneset
- Bërja e informatave publike në një pikë të vetme, uebsajt të vetëm
- Përrjashtime më shpjeguese, përcaktimi i vendimmarrjes, sidomos në rastet e refuzimeve.
- Kualiteti i të dhënave të publikuara në uebfaqe dhe për ripërdorim
- Edukimi i palëve të interesit
- Licenca të hapura për ri përdorimin e informatave
- Të dhëna të sakta dhe të përditësuara

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Së paku 30% e kërkesave për qasje në dokumente publike janë refuzuar duke mos u përgjigjur fare në to. Si shembull, Qeveria e Republikës së Kosovës³³, së bashku me agjencitë e saj vartëse, ka përdorur këtë mënyrë të refuzimit në 39% të të gjitha refuzimeve.

Pa përgjigje janë 39% e refuzimeve, ndërsa për të mbrojtur sigurinë publike janë refuzuar 17%. Barazia e palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë është arsyeja e 12% të refuzimeve, pasuar nga mbrojtja e privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat me 11% të të gjitha refuzimeve.




Institucionet e themeluara nga Kuvendi i Kosovës nuk kanë pasur gatishmëri për të raportuar për kërkesat e tyre për qasjen në dokumente publike, siç parashihet me Ligj.

Zyra për Komunikim Publik, ka adresuar një kërkesë tek Kuvendi i Kosovës në datën 15 tetor të vitit 2012, me të cilën është kërkuar nga Kuvendi që të kërkoj nga agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi dhe që raportojnë në Kuvendin e Kosovës, të prezantojnë raportet në lidhje me zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike për Zyrën për Komunikim në ZKM, duke sugjeruar që bëhet fjalë për një pasqyrë të të dhënave, dhe nuk përbën kurrfarë shkelje të ligjeve për themelimin e tyre dhe as cenim të pavarësisë së tyre institucionale. Megjithatë, asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje në këtë kërkesë.

Në vitin 2014 është rritur numri i institucioneve të cilat kanë dërguar raportet e plota për kërkesat që janë parashtruar drejtpërdrejt në këto institucione.

Deri më tani, 85.00% e institucioneve janë të përfshira në raportim.

³³<http://kryeministri-ks.net/repository/docs/SHQIP-FINAL.pdf>, faqe 28



Mungesa e raportimit nga Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial lë jashtë raportit edhe Gjykatat dhe Prokuroritë tjera të Kosovës, (Shih programi aktual)

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit rregullohet me themelimin e Komisionerit për Informim, i cili ekskluzivisht do të merret me mbikëqyrjen e ligjit për qasje në dokumente publike. Komisioneri për informim zgjedhet nga Kuvendi, për një mandate katër vjeçar me mundësi të rizgjedhjes. Institucioni i Komisionerit për Informim është i pavarur në punën e tyre dhe i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Detyrat kryesore të Komisionerit janë:

- Kryen detyrat e trupës mbikëqyrëse të shkallës së dytë, në lëshimin e vendimeve pas ankesave të marrë, në lidhje me të drejtën e qasjes në informacion dhe të drejtën e ri-përdorimit të informative
- Mbikëqyr zbatimin e Ligjit për Qasje në dokumente publike,
- Monitoron zbatimin e këtij ligji, rregulloreve të dala nga ai, si dhe informon publikun për këtë gjë,
- Bënë propozime tek institucionet publike lidhur me masat që duhet të ndërmarrin për të përmirësuar qasjen në informacion
- Informon publikun lidhur me beneficionet e ushtrimit të së drejtës për qasje në dokumente publike
- Propozon masa për edukim profesional të zyrtarëve përgjegjës për zbatimin e ligjit në institucione
- Inicion rregullore ose propozon amandamentimin e tyre, me qëllim të përmirësimit të zbatimit të së drejtës për qasje në informim
- Dërgon në Kuvend Raport gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve, lidhur me zbatimin e ligjit

Komisioneri, gjithashtu bënë edhe detyra tjera të ndërlidhura me mbrojtjen, monitorimin dhe promovimin e qasjes në informacion.

Në rast të refuzimeve, mos përgjigjes eventuale të institucioneve, Komisioneri për Informim do të mund të dënojë dhe gjobis institucionet publike. Vendimet e tij mund të apelojnë vetëm në Gjykatë.

Duke qenë një trup qendror mbikëqyrës, Zyra e Komisionerit për Informim do të mbikëqyr edhe uebsajtet zyrtare, për të parë nëse plotësojnë kriteret themelore për informatat që i përmbajnë

Opsioni 3: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Mundësi tjetër e përmirësimit të zbatimit të Ligjit, është dhënia e kompetencave të mbikëqyrjes të ligjit për qasje në dokumente publike, Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Modeli i tillë, i cili kohëve të fundit është duke u shtrirë në shumë vende evropiane, është parë si i përshatshëm dhe funksionon edhe në shtetet e rajonit, Shqipëri, Mal të Zi, Serbi dhe Slloveni.

Ky institucion, i cili në disa shtete njihet me emrin e Agjencisë për Qasje në Informata dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, e në disa si Komisioner i Informimit, është një trup mbikëqyrës me fuqi ekzekutive, që mbikëqyr ligjshmërinë e përpunimit të dhënave personale, po ashtu edhe lirinë e informimit.

Sa i përket të drejtës në qasje në dokumente publike, ky institucion ka këto detyra:

- Vendos në ankesat kundër vendimit të institucionit në shkallë të parë, që ka refuzuar kërkesën për qasje, ose ka shkelur të drejtën për ripërdorimin e informatave të sektorit publik.
- Mbikëqyr zbatimin e ligjit për qasje në dokumente publike dhe akteve nënligjore të dala nga ky ligj
- Ushtron detyra të mbikëqyrjes inspektuese të institucioneve publike
- Lëshon vendime për institucionet të cilët shkelin të drejtën e qasjes në dokumente publike. Vendimet e këtij institucioni mund të apelojnë vetëm në Gjykatë.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është agjenci e pavarur, e ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave. Anëtarët e saj veprojnë të pavarur në pajtim me këtë ligj dhe nuk duhet të pranojnë asnjë udhëzim nga palët e treta. Ajo i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.

Agjencia në veçanti:

- jep këshilla organeve publike dhe private për çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave;
- konsultohet nga Kuvendi dhe Qeveria lidhur me rastin e hartimit të masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale;
- vendos lidhur me ankesat e subjektit të të dhënave;
- bën inspektime dhe kontrole;
- informon publikun për çështjet dhe zhvillimet në fushën e mbrojtjes së të dhënave;
- promovon dhe përkrah të drejtat themelore për mbrojtjen e të dhënave personale;
- ka të drejtë të inicioj procedura gjyqësore
- parashtron kërkesë tek Gjykata Kushtetuese e Kosovës për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera kur konsideron se ato nuk janë në harmoni me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave siç parashihet në nenin 36 të Kushtetutës së Kosovës;
- parashtron padi në gjykatën kompetente, kur konsideron se e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale është shkelur ;
- jep autorizime për transferimin e të dhënave tek shtetet tjera dhe organizatat tjera ndërkombëtare;
- mban regjistrin e sistemit të dosjeve;

- bashkëpunon me organet shtetërore, ndërkombëtare dhe organet e BE-së lidhur me çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave. Aktualisht, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me ligj të Buxhetit ka të lejuar 23 të punësuar, nga të cilët numri aktual i të punësuarve janë 18. Me vetëm disa ndryshime strukturore, kjo agjenci bëhet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit edhe të Ligjit për qasje në dokumente publike.

Institucioni i pavarur, si i tillë do të kishte dy fusha të veçanta, njërën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe tjetrën për lirinë e informimit –ku përfshihen qasja në dokumente publike dhe të dhënat e hapura (Të parapara me Kartën për Hapjen e të Dhënave)³⁴. Ky institucion do të ketë fuqi ekzekutive, andaj mund të vendos gjoha ndaj organeve publike dhe private.

Agjencisë i jepet edhe fuqia për të mbikëqyrur uebsajtet zyrtare, për të parë nëse plotësojnë kriteret themelore për informatat që i përmbajnë, meqenëse zbulimi proaktiv i informatave është detyrë themelore, sipas rregullativës ndërkombëtare për lirinë e informimit.

Agjencia është institucion i pavarur, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, dhe do t'i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit. Në këtë drejtim, Raporti Gjithëpërfshirës për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike do të hartohet nga ky institucion, të dërgohet për shqyrtim nga Kuvendi i Kosovës.

Po ashtu, detyrë e tyre mbetet edhe hartimi i akteve nënligjore të dala nga këto dy ligje, përditësimi i tyre, mbajtja e trajnimeve për zyrtarët përgjegjës brenda institucioneve për zbatimin e këtij legjislacioni, por edhe mbajtja e fushatave vetëdijësuese për publikun.

Agjencia duhet të ketë vetëm një të emëruar nga Kuvendi i Kosovës.

Përparësitë e një trupe të vetme mbikëqyrëse për fushën e të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike janë si vijon:

- Interpretimet e shpeshta të konflikteve në mes të interesit të mbrojtës së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike/lirisë së informimit do të zgjidhen në mënyrë koherente dhe konsistente, përmes interpretimeve ligjore të nxjerra nga e njëjta trupë. Interpretime të ndryshme të nxjerra nga autoritete të ndara të cilave iu është besuar promovimi i të drejtës për qasje në dokumente publike, respektivisht mbrojtjen e të dhënave personale, mund të rrezikoj zbatimin e të dy të drejtave.

- Pjesëmarrja në rrjetin ndërkombëtar të autoriteteve të informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në ngjarjet ndërkombëtare që kanë synim forcimin e bashkëpunimit në mes tyre, (shembull, Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit, që mbahet çdo dy vjet) mund të kontribuoj në zbatimin efektiv të ligjeve për qasjen në dokumente publike në Kosovë, e që është njëri nga ligjet kyçe në luftimin kundër korrupsionit.

- Trupa e bashkuar mbikëqyrëse po ashtu do të siguroj dukshmëri më të madhe dhe unifikim të të gjithë praktikave ligjore në këtë fushë. Poashtu do të rris ndërgjegjshmërinë tek të gjitha trupat qeveritare, duke u siguruar që kërkuesit e dokumenteve të realizojnë të drejtën e tyre.

- Dy institucione të pavarura kërkojnë më shumë njerëz, financa dhe burime tjera se sa një institucion i vetëm.

³⁴ http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_87-te_te_Qeverise_2016.pdf

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-199 (Ligji mbi Gjykatat), gjykata kompetente në rast të konflikteve në fushën e qasjes në dokumente publike, do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Konfliktet Administrative, për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Opsioni 4. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Themelohet Njësia për qasje në dokumente publike, në kuadër të Zyrës për Komunikim me Publikun të Zyrës së Kryeministrit, sipas nenit 20 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Zyra e re mbikëqyr zbatimin e Ligjit tek institucionit publik, duke i këshilluar dhe hartuar udhëzues, por jo edhe duke pasur fuqi ekzekutive tek institucionet tjera.

Rritet vetëdija për nevojën e dhënies së më shumë informatave tek vendimmarrësit, dhe me këtë synohet që të rritet edhe vetëdijesimi i publikut për të mirën e qasjes në dokumente publike.

Kapitulli 5: Përmbledhja e opsioneve

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4
Karakteristikat kryesore të opsionit.	Status Quo	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike	Ndryshim dhe plotësimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit
Segmenti i popullsisë / sektori / rajoni i shënjestruar.				
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët.	Zyra për Komunikim me Publikun ZKM-së/Avokati i Popullit	Komisioneri për Informim	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Njësia për Qasje në Dokumente Publike/Zyra për Komunikim Publik në Zyrën e Kryeministrit
Administrimit ose zbatimit i programit ose shërbimit	Zyra për Komunikim Publik në ZKM/Avokati i Popullit	Komisioneri për Informim	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Njësia për Qasje në Dokumente Publike/Zyra për Komunikim Publik në

				Zyrën e Kryeministrit
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimimi dhe dënimet.	Nuk ndryshon asgjë	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike	Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike- Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Rregullore e veçantë për punën e Njësisë për Qasje në Dokumente Publike të ZKP-ZKM
Stimulimet ose mos stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat.	Nuk ka	Ka një treg, sidomos në zhvillimin e aplikacioneve për telefoninë mobile, nga ri-përdorimi i informatave nga sektori publik	Ka një treg, sidomos në zhvillimin e aplikacioneve për telefoninë mobile, nga ri-përdorimi i informatave nga sektori publik	Nuk ka
Fushatat e edukimit dhe komunikimit.	Fushatë vetëdijësuese për vendimmarrës	Fushatë vetëdijësuese e përgjithshme, lidhur me të drejtën e qasjes në dokumente	Fushatë vetëdijësuese për ndërlihdjen mes të dhënave personale, dhe të drejtës për të pasur qasje në dokumente, si dhe për ripërdorimin e tyre edhe për biznese	Fushatë vetëdijësuese për vendimmarrës
Udhëzimet dhe kodet.				
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni.				

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

Opsioni 1

Nuk ka përfitime

Opsioni 2

Përcaktohet shkalla e dytë për të ndihmuar qytetarët dhe akterët tjerë të shoqërisë për të realizuar të drejtën e qasjes në dokumente publike. Komisioneri për Informim ka fuqi ekzekutive dhe mund të gjobisë institucionet nëse nuk marrin parasysh vendimet e saj. Ka paanshmëri në marrjen e vendimeve, dhe ndaj këtij institucioni, mund të ngrihet padi vetëm në Gjykatë.

Ulen shpenzimet në Gjykata. Afati për realizimin e të drejtës së qasjes në dokumente publike do të shkurtohet dukshëm, meqenëse përcaktimi i shkallës së dytë do të bëjë që kërkuesit e dokumenteve mos të bëjnë kërkesë për rishqyrtim të çështjes tek institucionet publike, por në rast se janë të pakënaqur, menjëherë nisin procedurën tek Komisioneri për Informim.

Opsioni 3

Do të bëhet ristrukturimi i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe kostoja shtesë do të jetë më e ulët sesa kostoja e themelimit të një institucioni të ri. Agjencia do të ketë fuqi ekzekutive dhe do të gjobisë institucionet kur nuk i përfillin vendimet e saj. Është e paanshme në marrjen e vendimeve, dhe mund të nis procedurë gjyqësore.

Ekziston një trend i qartë në Evropë për të kombinuar funksionet e mbrojtjes së të dhënave personale me autoritetin kompetent për qasje në dokumente publike. Shembujt e shteteve që kanë themeluar trupa të tilla të bashkuara përfshijnë Shqipërinë, Gjermaninë, Hungarinë, Irlandën, Britaninë e Madhe, Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Estoninë, Slloveninë dhe Zvicrën.

Opsioni 4

Themelimi i njësisë së veçantë për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike në kuadër të Zyrës për Komunikim me Publikun të ZKM-së, do të ndihmonte institucionet në marrjen e vendimeve. Poashtu, do të mund të udhëzonte institucionet dhe të mbante trajnime për vendimmarrësit. Njësia do të organizonte edhe kampanja vetëdijësuese dhe fushata të ndryshme.

Pasojat negative

Opsioni 1

Nuk dihet përgjegjësia e vendimmarrjes, sidomos në rastet e refuzimeve. Mungesa e një trupe qendrore mbikëqyrëse me fuqinë e të dhënit të dënimeve në dështimin e dhënies së qasjes në dokumente publike është sfida kryesore.

Mbikëqyrja e zbatimit është e mangët, fillimisht, mundësia e rishqyrtimit të çështjes nga i njëjti institucion që e ka refuzuar, dmth dy faza të vendimmarrjes brenda të të njëjtit institucion publik, është e qartë që nga fillimi që vetëm e prolongon procesin.

Opsioni 2

Themelimi i Zyrës së Komisionerit për Informim kërkon buxhet shtesë për të siguruar punësimin e njerëzve ekspert. Poashtu kërkohet sigurimi i pavarësisë së plotë të këtij institucioni në marrjen e vendimeve.

Opsioni 3

Mungesa e buxhetit për të siguruar staf profesional dhe të mjaftueshëm për të përballuar zbatimin e ligjeve në kohë dhe në mënyrë të drejtë. E gjithë kjo, mund të ndikoj në performancën e institucionit.

Opsioni 4

Disa nga institucionet që janë themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk raportojnë tek Zyra e Kryeministrit, përfshirë këtu edhe vetë Institucionin e Avokatit të Popullit. Gjykatat dhe prokuroritë poashtu hezitojnë të raportojnë tek Zyra e Kryeministrit.

Edhe pse Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka ndonjë rol në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, shumë shpesh ndodh që ky institucion të marrë kërkesa të ndryshme, për të dhënë opinione edhe në rastet e shkeljes së të drejtës për qasje në dokumente.

Raportet gjithëpërfshirëse të realizimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, dërgohen vetëm për njoftim në Kuvendin e Kosovës. Roli i këtij institucioni mbetet i kufizuar, meqenëse edhe përgjegjësia e mbikëqyrjes është e shpërndarë në institucione të ndryshme.

Kapitulli 7: Konsultimi

Konsultimi me ekspertë (jashtë Qeverisë, ne Universitete ose Agjenci):

Më 17 shtator, Zyra për Komunikim Publik(ZKP) e Zyrës së Kryeministrit zhvilloi një takim konsultativ me dy këshilltarëve ligjorë të Komisionerit Slloven të Informacionit(KSI), znj. Jasna Duralija dhe znj. Maja Lubarda. Këshilltarët ligjorë nga KSI shqyrtuan Ligjin për QDP dhe kornizën e miratimit të qasjes. Të gjithë pjesëmarrësit arritën në përfundimin e përbashkët se Ligji aktual për Qasje në Dokumente Publike ka mangësi të mëdha dhe duhet të ndryshohet.

Përmbledhje e Rekomandimeve nga ekspertët slloven

1. Zyra e Kryeministrit duhet të inicioj amandamentimin e Ligjit për QDP
2. Ligji i amandamentuar për QDP duhet t'u japë Zyrtarëve për Informim autoritetin vendimmarrës mbi kërkesat për qasje në dokumente.
3. Ligji i amandamentuar për QDP duhet të përcaktoj një trup të pavarur mbikëqyrës për përputhshmërinë e institucioneve publike me kompetencat ndëshkimore. Ligji mund të fuqizoj Avokatin e Popullit apo të emërtoj një institucion të ri për këtë çështje.
4. Ligji i amandamentuar për QDP duhet të jetë në përputhje me direktivën e EU-së për ri-përdorim të informatave të sektorit publik.
5. Ligji i amandamentuar për QDP duhet të identifikoj saktësisht trupat (organet) për riadresim në rast konflikti.

6. Gjatë hartimit të projektligjit për amandamentimin e ligjit për QDP, Zyra e Kryeministrit duhet të shqyrtoj p/ligjin nga aspekti i konsistencës (përfshirë nenet 4 dhe 6.)
7. Ligji i amandamentuar për QDP duhet të përmbaj më shumë kufizime të përjashtimeve për qasje në dokumente publike.
8. Ligji i amandamentuar për QDP duhet të përfshij dispozitat për kryerjen e testit publik dhe testit të dëmit.
9. Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme duhet të shqyrtoj zbatimin e Ligjit për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Sigurisë dhe të identifikoj mangësitë,
10. Ligji i amandamentuar për QDP duhet të përcaktoj kartë rrethanat nën të cilat do të bëhet klasifikimi i një dokumenti.
11. Ligji i amandamentuar për QDP duhet t'i jap institucionit mbikëqyrës për qasje në informacion autoritet për të mbikëqyrë dhe në qoftë se është e nevojshme edhe të apeloj klasifikimin e dokumenteve publike.

Konsultime tjera me ekspertë:

Më 18 shtator 2014, Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë, mbajti në Prishtinë Konferencën Rajonale: Liria e Informimit – zhvillimi i praktikave në rajonin e Ballkanit Perëndimor³⁵.

Pjesëmarrësit:

1. Maja Lubarda, këshilltar ligjor i Komisionit të Informimit në Slloveni
2. Jasna Duralija, këshilltar ligjor i Komisionit të Informimit në Slloveni
3. Anamarija Musa, Komisioner i informimit në Republikën e Kroacisë
4. Dubravka Bevandic, shefe e sektorit ligjor, Komisioneri i Informimit në Kroaci
5. Šefko Crnovršanin, Drejtor i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informim në Mal të Zi
6. Biljana Bozic, anëtare e Këshillit të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informim në Mal të Zi
7. Dalina Žurić, këshilltare ligjore, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informim në Mal të Zi
8. Blerim Hyseni, nënkryetar i Komisionit për Mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik në Maqedoni
9. Katerina Dimeska, anëtare e Këshillit të Komisionit për Mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik në Maqedoni
10. Slavka Alagic, Shefe e sektorit për Qeverisje Publike në Ministrinë e Drejtësisë në Bosnje dhe Hercegovinë
11. Besnik Dervishi, Komisioner, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri,

³⁵<http://kryeministri-ks.net/?page=1,9,4455>

12. Arben Shkëmbi, Komisioner, Avokati i Popullit, Shqipëri,
13. Alket Jaupi, zëvendëskomisioner, Avokati i Popullit, Shqipëri
14. Ruzhdi Jashari, Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kosovë
15. Tafil Rrahmani, Drejtor i Departamentit të Hetimeve, Avokati i Popullit, Kosovë
16. Sofije Kryeziu, koordinatore e projektit, Qendra Kosova

Konkluzionet e kësaj Konference:

1. Nevoja e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave është e domosdoshme dhe në funksion të avancimit të realizimit të së drejtës së lirisë së informimit;
 2. Duke ditur që e drejta e informimit publik është e drejtë themelore e njeriut, angazhohemi për realizimin e plotë të saj;
 3. Është e domosdoshme nisja e zbatimit të Direktivës së Komisionit Evropian nr.2013/37/EU për ri-përdorimin e informacioni të sektorit publik;
 4. Praktikata e vendeve të rajonit dëshmojnë se organi që mbikëqyrë zbatimin e ligjeve të lirisë së informimit publik duhet të jetë i pavarur dhe me fuqi ekzekutive;
 5. Bashkëpunimi në fushën e lirisë së informimit publik do të vazhdojë në mënyrë intensive edhe në të ardhmen;
 6. Pajtohemi për krijimin e një forumi të veçantë të përfaqësuesve që merren me lirinë e informimit publik në vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe avancimin e realizimit të së drejtës për qasje në informacione me karakter publik;
 7. Të shikohen mundësitë që konferenca rajonale mbi lirinë e informimit publik, të jetë vjetore;
- Gjatë vitit 2015, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur ka mbajtur dy punëtori “Të dhënat e hapura” në Durrës, të parën më 26-28 qershor dhe të dytën më 31 tetor-01 nëntor.
- Pjesëmarrës në këto dy punëtori kanë qenë zyrtarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bizneset, shoqëria civile dhe mediat.
- Gjatë këtyre punëtorive është diskutuar për mënyrën se si do të mund që Kosova të fillojë hapjen e të dhënave, cili është modeli më i mirë, dhe se si mund të rregullohet me legjislacion kjo çështje.

Pjesëmarrësit:

1. Zyra e Kryeministrit
2. Ministria e Integritimit Evropian
3. Agjencia e Shoqërisë së Informacionit - MAP
4. Agjencioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
5. Instituti Riinvest
6. Grupi për Studime Juridike dhe Politike
7. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
8. Instituti Demokratik i Kosovës
9. Open Data Kosovo
10. OJQ Ec ma ndryshe

11. Iniciativa për Progres - INPO
12. Oda Ekonomike Amerikane
13. Lëvizja FOL
14. Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
15. Asociacioni Gazetareve të Kosovës

Konsultimi me ministrinë:

Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrit ka mbajtur punëtorinë “Sfidat në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, katër vite pas hyrjes në fuqi” më 10 tetor 2014 në hotelin “Sirius” në Prishtinë, me përfaqësuesit e institucioneve qendrore, ministrinë, si dhe agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës.

Pjesëmarrësit:

1. Agjencia Kosovare e Pronës
2. Ministria e Punëve të Jashtme
3. Banka Qendrore e Kosovës
4. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
5. Ministria e Zhvillimit Ekonomik
6. Instituti i Kosovës për Administratë Publike
7. Agjencia Kosovare e Privatizimit
8. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës
9. Ministria për Komunitete dhe Kthim
10. Autoriteti i Aviacionit Civil
11. Ministria e Forcës së Sigurisë
12. Ministria e Integritimit Evropian
13. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
14. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
15. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës
16. Agjencia e Barazisë Gjinore
17. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
18. Komisioni i Pavarur i Mediave
19. Komisioni Gjyqësor i Kosovës
20. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm,
21. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
22. Kuvendi i Kosovës
23. Policia e Kosovës
24. Ministria e Drejtësisë

Konkluzionet:

Ligji i amendamentuar i Qasjes në Dokumente Publike duhet të përmbajë:

1. Harmonizimin me Ligjin për Prokurim Publik

2. Harmonizimin me direktivën e Komisionit Evropian 2013/37/EU për ripërdorimin e informative publike
3. Qartësimi i shkallës së dytë dhe të tretë. Përkatësisht themelimi i Zyrës së Komisionerit të Informimit, si shkallë e dytë, dhe caktimi i Gjykatës kompetente si shkallë e tretë.
4. Komisioneri i Informimit të masë transparencën përmes publikimeve proaktive dhe kërkesave të realizuara për qasje në dokumente publike
5. Komisioneri i Informimit të mbledh Raportet Vjetore dhe t'i këshillojë institucionet në qartësimin e dilemave të ndryshme që dalin gjatë zbatimit të Legjislacionit
6. Në uebfaqe të publikohen dokumentet që tashmë janë dhënë, janë publikuar
7. Të përcaktohet detyrimi i institucioneve për të miratuar Kornizën e brendshme të Miratimit
8. E drejta për Debat Parlamentar mbi çështjet e kësaj fushe. Raporti t'i dërgohet Kuvendit për miratim nga Komisioneri i Informimit
9. Të parashihen lehtësime për mediat
10. Të harmonizohet Ligji i ri me Ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve
11. Identifikimi i të gjitha institucioneve publike
12. Hartimi i një Ligji të Veçantë për Zyrën e Komisionerit të Informimit
13. Harmonizimi me Ligjet e nivelit lokal. Qartësimi i obligimeve që dalin nga Ligji për Komunitat

Konsultimi me akter – organizatat ose individët që ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë:

Më 30 tetor 2014 në hotelin “Theranda” në Prizren, është mbajtur punëtorja me përfaqësuesit e komunave të Kosovës.

Pjesëmarrësit:

1. Komuna e Ferizajit
2. Komuna e Ferizajit
3. Komuna e Malishevës
4. Komuna e Suharekës
5. Komuna e Suharekës
6. Komuna e Prizrenit
7. Komuna e Prizrenit
8. Komuna e Gjilanit
9. Komuna e Skenderajt
10. Komuna e Drenasit
11. Komuna e Obiliqit
12. Komuna e Deçanit
13. Komuna e Mitrovicës
14. Komuna e Mitrovicës

Konkluzionet e kësaj punëtorie janë:

1. Ligji për Qasje në Dokumente Publike duhet të plotësohet
2. Duhet të përcaktohet Organi Mbikëqyrës me fuqi ekzekutive
3. Duhet të shkruhet në Ligj Gjykata që është kompetente

4. Ligji për Qasje në Dokumente Publike duhet të harmonizohet me ligjet tjera, Ligjin për Prokurim Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
5. Procedurat aplikimit duhet të thjeshtëzohen dhe të hiqen procedurat burokratik
6. Përjashtimet të jenë më shpjeguese
7. Të përcaktohet vendimmarrja, sidomos në rast të Refuzimeve
8. Ligji i ri të harmonizohet me Direktivën e BE-së për ripërdorimin e informatave të Sektorit Publik
9. Të bëhet Krijimi i regjistrave të dokumenteve që i posedojnë institucionet, si dhe regjistër i ndarë i dokumenteve që janë të klasifikuara

Konsultimi me publikun dhe shoqërinë civile

Më 7 nëntor 2014, Zyra për Komunikim me Publikun në ZKM në një tryezë të organizuar me mbështetjen e Misionit të OSBE-së ka takuar edhe përfaqësuesit e medieve dhe të shoqërisë civile.

Pjesëmarrësit:

1. Koha Ditore
2. Kosovapress
3. OJQ "AVD"
4. Gazeta Lajm
5. Botapress
6. KCSF
7. Kohavision
8. Rrokum
9. Radio Kosova
10. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut
11. OJQ Çohu!
12. RTK
13. BIRN
14. Infodirekt TV
15. Kosova Sot
16. D4D
17. FLOSSK

Konkluzionet e tryezës:

1. Është i nevojshëm rregullimi i Mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike
2. Institucionet duhet të kenë më mirë të rregulluar vendimmarrjen, sidomos në raste të Refuzimeve
3. Të bëhet Vlerësimi i Ndikimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike
4. Të shikohet mundësia e rishikimit dhe plotësim-ndryshimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike
5. Ligji të harmonizohet me Direktivën e BE-së 2013/37/EU për ripërdorimin e informatave të sektorit publik

6. Krijimi i databazave/regjistrave për dokumentet që i posedojnë institucionet, dhe që ky regjistër të jetë i qasshëm online
7. Rishikimi i dokumenteve të institucioneve të cilat janë të publikuara në mënyrë proaktive
8. Të bëhet Lista e Dokumenteve të Klasifikuara

Nga të gjitha këto konsultime, në këtë koncept dokument janë përfshirë këto rekomandime:

1. Zyra e Kryeministrit duhet të inicioj amandamentimin e Ligjit për QDP.
2. Ligji i amendamentuar për QDP duhet të përcaktoj një trup të pavarur mbikëqyrës për përputhshmërinë e institucioneve publike me kompetencat ndëshkimore. Ligji mund të fuqizoj Avokatin e Popullit apo të emërtoj një institucion të ri për këtë çështje.
3. Ligji i amendamentuar për QDP duhet të jetë në përputhje me direktivën e BE-së për ri-përdorim të informatave të sektorit publik.
4. Ligji i amendamentuar për QDP duhet të identifikoj saktësisht trupat (organet) për riadresim në rast konflikti.
5. Gjatë hartimit të projektligjit për amandamentimin e ligjit për QDP, Zyra e Kryeministrit duhet të shqyrtoj p/ligjin nga aspekti i konsistencës (përfshirë nenet 4 dhe 6.)
6. Ligji i amendamentuar për QDP duhet të përmbaj më shumë kufizime të përjashtimeve për qasje në dokumente publike.
7. Ligji i amendamentuar për QDP duhet të përfshij dispozitat për kryerjen e testit publik dhe testit të dëmit.
8. Të përcaktohet detyrimi i institucioneve për të miratuar Kornizën e brendshme të Miratimit
9. Identifikimi i të gjitha institucioneve publike
10. Duhet të shkruhet në Ligj se cila Gjykatë është kompetente
11. Ligji për Qasje në Dokumente Publike duhet të harmonizohet me ligjet tjera, Ligjin për Prokurim Publik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
12. Përjashtimet të jenë më shpjeguese
13. Të përcaktohet vendimmarrja, sidomos në rast të Refuzimeve
14. Të bëhet Krijimi i regjistrave të dokumenteve që i posedojnë institucionet, si dhe regjistër i ndarë i dokumenteve që janë të klasifikuara
15. Krijimi i databazave/regjistrave për dokumentet që i posedojnë institucionet, dhe që ky regjistër të jetë i qasshëm online
16. Rishikimi i dokumenteve të institucioneve të cilat janë të publikuara në mënyrë proaktive

17. Vendosja e rregullave më të qarta për procedimin e kërkesave për qasje në dokumente publike tek institucionet publike
18. Limitimi i shpenzimeve për kopjimin e dokumenteve të cilave iu jepet qasje e lejuar nga institucionet publike

Kapitulli VIII: Krahasimi i opsioneve

Nëse krahasojmë katëropsionet atëherë do të kemi këto pasoja:

- Pasojat kryesore të opsionit të parë, mbeten problemet e marrjes së vendimeve brenda institucioneve publike, sidomos në rastet e refuzimeve. Mungesa e një trupe qendrore mbikëqyrëse me fuqinë e të dhënies të dënimeve në dështimin e dhënies së qasjes në dokumente publike është sfida kryesore
- Pasojat kryesore të opsionit të dytë, rregullohet shkalla e dytë, arrihet të ketë një trupë e cila do të mund të ndihmonte të gjithë kërkuarit e dokumenteve që të realizojnë të drejtën e tyre, të qasjes në dokumente publike. Rritet tregu i ripërdorimit të informatave nga sektori publik, dhe kjo ndihmon në ekonominë e vendit.
- Pasojat kryesore të opsionit të tretë, me pak ndryshime në dy ligje, për qasje në dokumente publike dhe atij për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të bëhet që Organi mbikëqyrës të jetë Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke ndjekur kështu shembullin e Sllovenisë dhe të Malit të Zi nga vendet e rajonit, ku i njëjti institucion mbikëqyr këto dy ligje. Nuk ka kosto të themelimit të një institucioni të ri, dhe poashtu bëhet unifikimi i pikave të kontaktit nëpër institucione që janë të caktuar për mbrojtjen e të dhënave personale, përkatësisht qasjes në dokumente publike.
- Pasojat kryesore të opsionit të katërt, ndihmesa e një njësie të tillë do të ishte e mirëseardhur për të gjitha institucionet publike, sidomos në nxjerrjen e udhëzuesve të ndryshëm apo edhe në mjetin e trajnimeve. Megjithatë, jo të gjitha institucionet, sidomos gjykatat dhe prokuroritë, nuk janë të gatshme të bashkëpunojnë e të raportojnë tek Qeveria, pasi e konsiderojnë këtë një shkelje të pavarësisht së tyre institucionale, dhe shkelje e drejtpërdrejt e ligjit me të cilën janë themeluar.

Kapitulli IX: Rekomandimi

Në bazë të opsioneve të përmendura më lartë, Zyra për Komunikim me Publikun e Zyrës së Kryeministrin rekomandon opsionin e tretë.

Kapitulli 10: Komunikimi

Emri i dokumentit :

**KONCEPT DOKUMENT PËR HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN I LIGJIT Nr. 03 / L-215, PËR QASJE NË DOKUMENTE
PUBLIKE**

Komunikimi me media	
Konferencë për media	<input type="checkbox"/>
Konferencë për media të përbashkëta me institucione të tjera	<input checked="" type="checkbox"/>
Komunikatë për media	<input checked="" type="checkbox"/>
Fletë fakte	<input type="checkbox"/>
Punëtoritë me media (Ëorkshopet)	<input checked="" type="checkbox"/>
Debatet dhe intervistat në media	<input checked="" type="checkbox"/>
Publikimi në ueb-faqe	
Publikimi në ueb-faqe zyrtare të Zyrës së Kryeministrit	<input checked="" type="checkbox"/>
Publikimi në rrjetet sociale	<input checked="" type="checkbox"/>
Raportet dhe publikimet	
Raport të shtypur	<input type="checkbox"/>
Raport elektronik	<input checked="" type="checkbox"/>
Fletëpalosje të shtypur	<input type="checkbox"/>
Fletëpalosje elektronike	<input type="checkbox"/>
Libër të shtypur	<input type="checkbox"/>
Libër elektronik	<input type="checkbox"/>
Broshurë të shtypur	<input type="checkbox"/>
Broshurë elektronike	<input type="checkbox"/>
Buletin të shtypur	<input type="checkbox"/>
Buletin elektronik	<input type="checkbox"/>
Komunikimi direkt me opinionin publik	
Forum publik	<input type="checkbox"/>
Konferencë publike	<input type="checkbox"/>
Dëgjim publik	<input checked="" type="checkbox"/>

Kampanja mediale	
TV kampanja	
Javore	<input type="checkbox"/>
Mujore	<input type="checkbox"/>
Vjetore	<input type="checkbox"/>
Radio kampanja	
Javore	<input type="checkbox"/>
Mujore	<input type="checkbox"/>
Vjetore	<input type="checkbox"/>
Kampanja në mediat e shkruara	
Javore	<input type="checkbox"/>
Mujore	<input checked="" type="checkbox"/>
Vjetore	<input type="checkbox"/>
<p>Të tjera(<i>propozo mënyrë dhe formë tjetër të komunikimit dhe plasimit të informatës për dokumentin në fjalë</i>)</p>	